

DEKRET
Nr. 387, datë 31.10.2025

**PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT
VAKANT GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pika 1, shkronja “b”, dhe pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, 7/“a” dhe 7/“b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pas administrimit të shkresës nr. 820 prot., datë 24.10.2025, të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, me anë të së cilës njoftohet se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 65, datë 24.10.2025, ka vendosur: “Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Sonila Bejtja, në datën 25.4.2025”, me cilësinë e organit të emërtesës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e vakancës së krijuar sipas vendimit nr. 65, datë 24.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Shpallja e kësaj procedure dhe publikimi i saj, sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj